

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RTSH-SË PËR VITIN 2006

Kuvendi, pasi u njoh me raportin e Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2006, vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së raporton në Kuvend në kushtet kur si institucion drejtues i RTSH-së ka vetëm disa muaj që është zgjedhur në detyrë;
- RTSH-ja vepron në kushtet e konkurrencës së operatorëve të tjerë në tregun mediatik dhe për të balancuar përparësitë që zotëron, duhet dhe po punon për përmirësimin e parametrave teknologjikë dhe të kushteve të tjera që lidhen me to;
- Këshilli i ri Drejtues ka bërë përpjekje për përmirësimin e punës së RTSH-së, duke ndërmarrë masa sidomos në ndryshimet e stafit ekzekutiv të këtij institucioni;
- ka përpjekje nga ana e strukturave drejtuese të RTSH-së për vënien në lëvizje të procesit të reformimit të RTSH-së drejt një televizioni krejtësisht publik, siç e përcakton ligji;
- kërkohet një mbështetje më e madhe e strukturave shtetërore, në mënyrë që RTSH-ja të realizojë këtë qëllim, si dhe një rishikim i kuadrit ligjor e normativ, që rregullon veprimtarinë e këtij institucioni.

Kuvendi vlerëson se:

- ka arritje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale në programet e RTSH-së;
- ka realizime në përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së dhe drejtimin e saj kah publiku.

Për këtë Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së që:

- strukturat drejtuese të RTSH-së të njihen më mirë me detyrimet ligjore dhe detyrimet që rrjedhin nga rezolutat e miratuara deri tani nga Kuvendi për veprimtarinë e RTSH-së, ku përcaktohen drejtime të rëndësishme të punës në RTSH;
- të zbatojë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 120 të ligjit nr.8410 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe në statutin e RTSH-së për publikimin e raportit të analizës financiare të Bordit të Administrimit të RTSH-së;
- të hartojë brenda këtij viti kalendarik strategjinë e shndërrimit të plotë të RTSH-së në transmetues publik;
- të realizojë sa më parë detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 71 të ligjit nr. 8410 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” për mbulimin me sinjal të popullsisë dhe territorit në Republikën e Shqipërisë;
- të realizojë detyrimet ligjore dhe institucionale që kanë të bëjnë me miratimin e strukturës organizative, programore dhe reformën e pagave në RTSH;
- të përgatisë dhe të hartojë propozimet e veta në procesin e rishikimit të legjislacionit të ndërmarrë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në mënyrë të veçantë të statutit të RTSH-së, duke marrë në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga ekspertët e institucioneve ndërkombëtare dhe detyrimet që ka Republika e Shqipërisë në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit
- të lirojë mjediset e duhura për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

5 prill 2007